

PËR ARSIMIN, GRUAN DHE RININË

PËR SHËNDETËSINË

PËR POLITIKAT SOCIALE

PËR EKONOMINË

PËR MJEDISIN DHE TURIZMIN

PËR BUJQËSINË

PËR POLITIKËN E JASHTME

PËR ENERGJINË

PËR INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN

FISKALE DHE BUXHETORE

POLITIKE

The background of the entire page is a solid purple color. In the center, there is a dark purple rectangular box containing the main title in white text. Silhouettes of people with their arms raised are visible at the top and bottom edges of the page, suggesting a crowd or a celebratory atmosphere.

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PS, 2021

PREMTIME PËR ARSIMIN, GRUAN DHE RININË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Pagat e arsimtarëve do të rriten me 40% ¹
2	Libra falas për të gjithë nxënësit e arsimit para-universitar ²
3	Krijimi i një sistemi virtual alternativ shkollimi, me lidhje apo pa lidhje të domosdoshme në internet
4	Mbyllja përfundimtare e praktikës së vjetër të klasave kolektive në zonat e largëta, nisur nga eksperiencia e pandemisë
5	Do të ngremë kampusin e ri Universitetit Tiranës, si dhe do të përfundojmë kampusin e Universitetit Bujqësor, Akademisë së Arteve, Universitetit Politeknik dhe Akademisë së Sigurisë
6	Fundi i mësimit me dy turne për shkak të mungesës së klasave deri në 2025 ³
7	Program Kombëtar 10 vjeçar për kodimin për fëmijët 12-18 vjeç dhe qendra të specializuara të hyrjes në botën digjitale
8	Do të çelim programin kombëtar të arteve dhe zejeve për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme
9	Edukimi fizik do të zënë një vend më të rëndësishëm në sistemin arsimor, nga klasa e parë deri në universitet
10	Gjuha angleze do të nisë të mësohet në të gjithë shkollat e vendit që nga klasa e parë
11	Financim me 10 milion Euro në vit për universitet për afrimin e studimit me vendet e BE
12	Deri në vitin 2025, të gjithë drejtuesit e shkollave do të licensohen nga shkolla e drejtorëve si menaxherë të kualifikuar
13	Do të mbështesim çdo sinergji të plotë mes një universiteti shqiptar dhe një të huaj publik në anglisht
14	Paketa e inovacionit do të ofrojë kualifikime në novacion duke mbuluar kostot 100% nga qeveria

¹ <https://www.ps.al/te-reja/rruga-drejt-25-prillit-shkolla-dhe-universiteti-ne-planin-e-veprimit-2021-2025>
pagat e mësuesve që i kemi rritur 32%

² tekstet shkollore janë falas për 250 mijë nxënës dhe librat e fëmijëve tanë, të fëmijëve të Shqipërisë, janë prodhime të shtëpive prestigjioze të Oxford, Cambridge dhe Pearson

³ kemi investuar 130 milionë dollarë për 263 shkolla të reja ku mësojnë 114 mijë nxënës. Këtë vit vazhdon pa pushim me 3 turne, në të shumtën e herës, rindërtimi i 120 shkollave të reja për 40 mijë nxënës të tjerë

15	Fuqizim të kurseve të personalizuara për fëmijët
16	Dixhitalizimi i gjithë sistemit para universitar
17	Universitetet tona do të njehsohen me universitete publike europiane apo të vendeve të tjera mike
18	Programet profesionale do t'i çojmë në një nivel tjetër, në bashkëpunim të ngushtë me universitetet publike dhe private dhe me aktorët e tregut
19	Universitete të spikatura publike të vendeve mike, të jenë integruar në sistemin e arsimit tonë të lartë publik

PREMTIME PËR SHËNDETËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri
2	100 qendra shëndetësore dhe ambulanca të rehabilituara deri në vitin 2024
3	6 spitale rajonale me shërbim të ri të obstetri gjinekologjisë dhe pediatriisë. 2 spitale universitare të obstetri gjinekologjisë
4	4 spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese
5	Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare
6	Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor ⁴
7	Do të ndryshojmë administrimin e brendshëm të spitaleve
8	Mjekët do të fillojmë t'i paguajmë jo të gjithë njësoj, por sipas performancës së tyre
9	Ndërtimi i spitalit të ri të Laçit
10	Spital i ri rajonal në Shkodër, i njëjtë me standardet e spitalit të Fierit

⁴ sot prej vitesh mbeten në arkën e familjeve, 18 milionë dollarë nëpërmjet reformës së uljes së çmimit të barnave. Lista e barnave të rimbursueshme është pasuruar me 191 barna të reja dhe përfitimi i të gjithëve është fare i qartë

PREMTIME PËR EKONOMINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Biznesi i vogël dhe rregullimi i problemit të pronave janë dy prioritetet e para të qeverisë së ardhshme
2	Do ta bëjmë Shqipërinë kampione të Ballkanit në këtë dekadë në turizëm, në agroturizëm dhe në eksporte bujqësore
3	Rritja e pagës minimale vit pas viti deri në 40 mijë lekë në fund të mandatit
4	Paga mesatare bruto në rang vendi do të shkojë në 85 mijë lekë bruto
5	Ngritje e fashës me disa shkallë më shumë, duke e çuar tatimin 23% mbi pagën 250 mijë lekë/muaj
6	Krijohet një fond kreditimi prej 10 milionë Euro për manufakturën
7	Lehtësim i procedurave të rekrutimit me 3 muaj integrim të rimbursuar për çdo punësim të ri
8	Nxitje transformimin e proceseve të prodhimit duke mbështetur blerjen e makinerive të industrisë 4.0 nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40%
9	Kalimi i gjithë sistemit të manufakturës, që njihet si fason, në një nivel tjetër, duke synuar prodhimtarinë me cikël të mbyllur "made in Albania"
10	Do të kemi një metropol Tiranë – Durrës
11	Park industrial në Lezhë pranë zonës aeroportit të Gjadrit ⁵

⁵ <https://www.ps.al/te-reja/rruga-drejt-25-prillit-prezantimi-i-skuadres-fituese-ne-qarkun-e-lezhes>

PREMTIME PËR MJEDISIN DHE TURIZMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Shteti shqiptar do të subvencionojë dhe operatorët turistikë
2	Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit
3	Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik
4	Zona të reja të zhvillimit turistik, në total 6 zona
5	Muzeu i ri Etnografik në Gjirokastrë dhe bypass i zonës historike
6	Muze historik në Tepelenë
7	Qendër e re turizmi në Korçë

PREMTIME PËR BUJQËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1.	Ulje TVSh-në për grumbulluesit në 6%
2.	Eksportet bujqësore i kemi rritur në 400 milionë US. D, ishin rreth 100 milionë US.D. Do t'i çojmë mbi 1 miliardë US.D
3	Dyfishimi i numrit të bagëtive të imta nga 2 milionë në 4 milionë
4	Do të garantojmë aksesin në programin IPARD III me fond financimi 166 milionë Euro
5	16 milionë US.D në vitin 2025 për të mbështetur më shumë kultura të mbjelljes
6	Grant 5.000 Euro për emigrantët që investojnë në agroturizëm

PREMTIME PËR POLITIKËN E JASHTME

Nr.	Premtimi elektoral
1	E çojmë Shqipërinë në një nivel tjetër që të jetë në një pozicion që nuk mund të kthehet më pas

PREMTIME PËR ENERGINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Shqipëria kthehet në eksportues neto të energjisë ⁶
2	Do të ndërtojmë e të transformojmë nënstationet e tjera në rang vendi
3	Do të rrisim sigurinë e furnizimit për të gjithë, përmes fuqizimit pikërisht të kapaciteteve të shpërndarjes së energjisë elektrik ⁷
4	Do të vijojmë të ndërtojmë një rrjet të ri 20 kilovolt me një seri kabinash të tjera
5	Do të fuqizojmë aspektin teknologjik smart, digjital, në monitorim e në operim përmes një sistemi që tanimë është i instaluar në Shqipëri
6	Park i prodhimit të energjisë së erës në Lezhë
7	Do ta çojmë në mandatin e tretë nivelin e humbjeve teknike në energji në 10%
8	Vlora një qendër rajonale për gazin e lëngshëm natyror
9	Dy investime madhore me amerikanët, në Skavicë tjetrin në TEC-in e Vlorës për gazin e lëngshëm

⁶ gjithë ato para që ne i harxhojmë për të importuar energji nuk do të jenë më para që do të harxhohen, por do të mbeten këtu në ekonomi

⁷ ku kemi investuar afro gjysmë miliardi dollarë e ku kemi ndërtuar një seri të tërë veprash

PREMTIME PËR INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Ujë të pijshëm 100% në 24 orë, brenda vitit 2022, në zonat urbane të 61 bashkive të vendit ⁸
2	Rritje e buxhetit për ujin në mandatin e tretë, me 40%, nga buxheti i shtetit dhe mbështetjes nga fondet e huaja
3	Ndërtimi i 2 aerodromeve në Gjirokastrë ⁹
4	Ndërtimi i aeroportit në Vlorë
5	Ndërtimi i aeroportit të ri në Sarandë
6	Ndërtimi i aeroportit të ri në Korçë
7	Porti i Durrësit me investimin prej 2 miliardë Euro pas marrëveshjes së bashkëpunimit me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara, do të kthehet në marinën më të madhe të Mesdheut.
8	Ndërtimi i 3 porteve në Vlorë, porti turistik, porti i mallrave dhe porti i peshkatarëve
9	Port i ri turistik në Sarandë
10	Porti i ri turistik i Lezhës, porti i katërt i zinxhirit porteve
11	Do rikthejmë si projekt prioritar Boshtin e Jugut, nga Hani i Hotit deri në Përmet
12	Linja e re hekurudhore Pogradec-Korçë-Greqi
13	Përfundimi i akseve Balldren-Milot dhe Milot-Fier
14	Brenda vitit 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit
15	30.7 miliardë Lekë ¹⁰ ku pjesa kryesore do të jetë për grante rikonstruksioni e rindërtimi ¹¹ dhe për banesat ¹²

⁸ 120 e ca kantierë që sot punojnë për të garantuar që në të gjitha qendrat urbane të Shqipërisë

⁹ një aeroport e ka kthimin e investimit në ekonomi 1 Euro e shpenzuar në 23 Euro të kthyer, në një periudhë afatmesme

¹⁰ rreth 245 milionë Euro

¹¹ 14.6 miliardë Lekë

¹² 6.8 miliardë Lekë

16	Në dhjetor 2021 përfundon e gjithë Unazën e Madhe të Tiranës
17	Përfundimi brenda verës 2021 i dy akseve Tepelenë-Lekdush dhe Gusmar-Kuç
18	Ndërtimi i segmentit rrugor “Orikum – Llogara”
19	Ndërtimi i segmentit “Thumanë – Kashar”
20	Ndërtimi i rrugës “Kardhiq-Delvinë”
21	Rrjet i ri ujësjetllësi në Vlorë, furnizim 24 orë me ujë
22	Rindërtimi i sheshit të Flamurit
23	Projekt i infrastrukturës turistike në Vlorë, që do të lidhë Ujin e Ftohtë me Radhimën e Orikumin
24	“Air Albanian” duam ta çojmë në fluturimet përtej oqeanit
25	Investim për portin e Himarës, për ta shndërruar në Port turistik

PREMTIME FISKALE DHE BUXHETORE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Lehtësim barrës tatimore dhe kompanitë do të kenë më shumë likuiditet ¹³
2	Prej 1 janari 2022, rimbursimi i TVSH-së do të jetë automatik
3	Nga 1 janari i vitit 2022 do të hiqet taksa mbi pagën aktuale deri në 40 mijë lekë
4	Biznesi i vogël nuk do ketë më inspektor te dera, nuk do ketë më kontrolle fare sepse gjithçka do jetë dixhitale
5	Do të vazhdojnë të përmirësohen e të shtohen marrëdhëniet me shtetin dhe lehtësirat që biznesi i madh përfituar
6	Biznesi i vogël do t'i ketë taksat dhe TVSH-në zero deri në vitin 2029 ¹⁴
7	Paketa e inovacionit dhe IT. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar apo i punësueshëm përfituesi
8	Reforma e fiskalizimit mbyllet brenda mandatit të tretë, me përfundimin e ngritjes së sistemit online ku do të kryhen të gjitha transaksionet dhe shërbimet. Nga kjo reformë synohet rritja me 30 % e të ardhurave në PBB
9	Pagesa e taksave do të jetë digjitale
10	Do të rriten me 30% pagat e administratës publike

¹³ 63% e njerëzve që punojnë në shtet ose në privat kanë një rrogë deri në 400 mijë lekë

¹⁴ <https://www.ps.al/te-reja/rruga-drejt-25-prillit-pagat-taksat-dhe-biznesi-ne-planin-e-veprimit-2021-2025>

PREMTIME POLITIKE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të mbyllim përfundimisht pronën si çështje, qoftë në qytet, qoftë në fshat
2	Reforma në Drejtësi dhe domosdoshmëria për të konsoliduar pozicionin e drejtësisë së re

PREMTIMET PËR POLITIKAT SOCIALE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Subvencionimin me pagesë me çerdhet dhe kopshtet private, për subvencionimin e pagesës në rastet e pamundësisë së gjetjes së vendeve të lira në strukturat shtetërore
2	Dyfishimi i fondit për kreditë e buta për strehimin e familjeve të reja
3	Brenda vitit 2022, përfundon ndërtimi i rreth 12 mijë apartamenteve në lagjet e reja dhe rehabilitimi i 160 shkollave

PREMTIME TË PËRGJITHSHME

Nr.	Premtimi elektoral
1	Marrja e përgjigjes online me nënshkrim, vulë elektronike për të gjitha shërbimet në e-albania që janë aplikime ¹⁵
2	Dixhitalizimi i të gjithë arkivave fizike për ta rritur numrin e shërbimeve dhe për ta bërë shërbimin automatik
3	Zero rritje të pagës së deputetëve dhe ministrave deri në 2025
4	Asgjësojmë korrupsionin që ka të bëjë me këto marrëdhënie që zgjidhen nga shteti dixhital
5	Krijimin e një shteti dixhital në të gjitha shërbimet ¹⁶

¹⁵ <https://www.ps.al/te-reja/rruga-drejt-25-prillit-sherbimet-per-qytetaret-dhe-biznesin-vizioni-shqiperia-2030>

¹⁶ 1% ishin shërbime online deri para 7 vjetësh.

95% janë sot, por shikoni çfarë ndryshimi. Kur ne e kemi filluar revolucionin digjital kemi numëruar gjithsej 51 mijë aplikime. Çfarë janë 51 mijë aplikime për shërbime kryesisht të pamarras asokohe, aplikime të mbetura në icloud në krahasim me 7.7 milionë aplikime të bëra në vitin 2020 me përgjigje të marrë.

50 mijë të regjistruar ishin shqiptarët në portalin që supozohej se u ofronte shërbime.

Me revolucionin digjital, sot që flasim janë 1.87 milionë të regjistruar që përdorin platformën, përdorin shërbimet.

6 ishin regjistrat elektronikë që presupozehej se duhet të ndërvepronin në platformën qeveritare.

Sot janë 55 regjistra elektronikë që ndërveprojnë në kohë reale.

Deri në 2013 numri total i transaksioneve, pra i ndërveprimeve të kryera në platformë ishin 680 mijë.

Sot, shifra e fundit e 2020 është 145 milionë.

PËR ARSIMIN, GRUAN DHE RININË

PËR SHËNDETËSINË

PËR POLITIKAT SOCIALE

PËR EKONOMINË

PËR MJEDISIN DHE TURIZMIN

PËR BUJQËSINË

PËR POLITIKËN E JASHTME

PËR ENERGINË

PËR INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN

FISKALE DHE BUXHETORE

POLITIKE

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PS, 2021

ALTAX